**VENDIM**
**Nr.222, datë 25.7.2011**

**PËR ZGJERIM ZONE LICENCIMI PËR RADION PRIVATE VENDORE "ALBANIA FM" SUBJEKTIT: SHOQËRIA "ALBANIA FM" SHPK**

Në mbështetje të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 "Për radion dhe televizionin publik dhe privat në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, rregullores së KKRT-së "Mbi kriteret për dhënien e licencave për transmetime televizive dhe radio FM analoge tokësore në nivel vendor", miratuar me vendimin nr.355, datë 29.8.2005 dhe rregullores së KKRT-së "Për licencimin e operatorëve privatë për transmetim radioteleviziv analogjik tokësor në nivel vendor", rregullores së KKRT-së "Mbi procedurat e licencimit dhe rilicencimit të operatorëve privatë radio e televizivë", miratuar me vendimin nr.1, datë 29.1.2010, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit, pasi mori në shqyrtim kërkesën e shoqërisë "Albania FM" sh.p.k., për zgjerimin e zonës së licencimit dhe mbështetur në propozimin e Komisionit të Shqyrtimit të Dokumentacionit, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit

VENDOSI:

1. Të miratojë zgjerimin e zonës së licencimit të shoqërisë "Albania FM" sh.p.k., për radion private vendore "Radio Albania FM", sipas licencës nr.058/FML, në rrethet Tiranë-Durrës.
2. Karakteristikat teknike janë pjesë përbërëse e licencës përkatëse dhe i nënshtrohen të gjitha kushteve të saj.
3. Ngarkohet administrata e KKRT-së për pasqyrimin e ndryshimeve përkatëse në licencën e subjektit.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE
**Endira Bushati**